

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“Dexi AL” SHPK**

Sot, më 05.11.2020, themelohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar (në vijim, “**Ligji për Shoqëritë Tregtare**”), nga personi juridik si vijon:

*“Dexi Global Inc., një shoqëri ekzistuese dhe e organizuar sipas ligjeve të Shtetit të Delauer, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me seli në adresën: “Cogency Global Inc., 850 New Burton Road, Suite 201, Dover, Kent County, Delaware 19904”, përfaqësuar nga Drejtori i Ekzekutiv dhe përfaqësuesi i autorizuar, z. Jacob Laurvigen”.*

Shoqëria dhe marrëdhëniet midis ortakëve të saj rregullohen nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe dispozitat e këtij statuti (në vijim, “**Statuti**”), i cili shërben gjithashtu si akt themelimi i shoqërisë.

**KAPITULLI**

**THEMELIMI, EMRI, SELIA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHEZGJATJA, DEGËT DHE ZYRAT E PËRFAQËSIMIT, PËRGJEGJËSITË E ORTAKËVE**

**Neni 1**

**Themelimi dhe Emri**

- 1.1. Më 05.11.2020, ortaku i sipërpërmendur themeloi një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar “**Dexi AL**” (në vijim, “**Shoqëria**”). Shoqëria fiton personalitet juridik pas regjistrimit në Regjistrin Tregtar Shqiptar, të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
- 1.2. Ndryshimi i emrit të Shoqërisë kryhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 2**

**Forma ligjore**

- 2.1 “**Dexi AL**” është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SHPK).
- 2.2 Gjatë kohëzgjatjes së saj, emri i Shoqërisë do të shoqërohet nga prapashtesa “SHPK” duke treguar formën e saj ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 3**

**Selia**

- 3.1 Selia Shoqërisë do të jetë në adresën: “*Rruga Ismail Qemali, pallati nr. 27, hyrja 1, kati VI, apartamenti 24, Bashkia Njësia 5, Tiranë, Shqipëri*”.
- 3.2 Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.



#### **Neni 4**

##### ***Objekti i veprimtarisë***

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë në Shqipëri është kryerja e shërbimeve profesionale dhe përpunimi i të dhënave nga interneti.
- 4.2 Shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregtare, industriale, financiare, operacione me pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme që konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për t'u kryer dhe për të përmbushur qëllimin e veprimtarisë së saj, duke specifikuar që veprimtaria financiare do të kryhet posacërisht në kuadër të këtij objekti veprimtarie.
- 4.3 Në përgjithësi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme dhe të dobishme, të lejuar nga legjislacioni në fuqi, me qëllimin e përmbushjes dhe ushtrimit të objektit të saj të veprimtarisë.
- 4.4 Shoqëria mund të ofrojë shërbime të tjera dhe të kryejë veprimtari të tjera me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- 4.5 Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj, në çdo kohë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe këtij Statuti.

#### **Neni 5**

##### ***Kohëzgjatja***

- 5.1 Shoqëria do të kryejë veprimtarinë e saj për një periudhë të pakufizuar kohore, duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar.
- 5.2 Shoqëria mund të ndryshojë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Statut.

#### **Neni 6**

##### ***Degët dhe zyrat e përfaqësimit***

Shoqëria mund të hapë degë, shoqëri të kontrolluara, zyra përfaqësimi dhe të kryejë veprimtari biznesi në vende të tjera, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **Neni 7**

##### ***Përgjegjësitë e ortakëve***

- 7.1 Ortakët nuk janë përgjegjës për detyrimet e Shoqërisë, si dhe mbulojnë personalisht humbjet e saj deri në vlerën kontributeve të pashlyera, të tyre, në kapitalin e shoqërisë.
- 7.2 Ortakët do të ushtrojnë detyrat e tyre me kujdesin e duhur dhe ndershmëri në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

### **KAPITULLI II**

#### ***KAPITALI I SHOQËRISË DHE KUOTAT, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË PËRBASHKËT, TRANSFERIMI I KUOTAVE***



## Neni 8

### *Kapitali dhe kuatat*

- 8.1 Kapitali i Shoqërisë është në para, i barabartë me 100 (njëqind) Lekë. Kapitali i Shoqërisë është i papaguar.
- 8.2 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 100 (njëqind) Lekë, që përkon me 100% (njëqind për qind) të kapitalit të Shoqërisë, i cili zotërohet tërësisht dhe është nënshkruar nga ortaku si vijon:
- **“Dexi Global Inc.**, një shoqëri ekzistuese dhe e organizuar sipas ligjeve të Shtetit të Delauer, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me seli në adresën: *“Cogency Global Inc., 850 New Burton Road, Suite 201, Dover, Kent County, Delaware 19904”*.

## Neni 9

### *Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë*

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet, në çdo kohë, vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## Neni 10

### *Zvogëlimi i kapitalit të Shoqërisë*

Kapitali i Shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

## Neni 11

### *Transferimi i kuotave të kapitalit të regjistruar*

- 11.1 Transferimi i kuotave do të realizohet vetëm nëpërmjet një dokumenti të shkruar, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 11.2 Nëse kapitali Shoqërisë zotërohet nga më shumë se 1 (një) ortak, kufizimet vijuese (siç përcaktohen në pikat 11.3 e vijuese të këtij neni 11) do të zbatohen në lidhje me transferimin e kuotave, me qëllim mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, unitetin e Ortakëve dhe qëndrueshmërinë e marrëdhënies së tyre.
- 11.3 Në rast se një ortak dëshiron të transferojë kuotën e tij (përfshirë një transferim pa kompensim) të palët e treta, transferimi i nënshtrohet të drejtës së parablerjes të ortakëve ekzistues të Shoqërisë në lidhje me kuotën (pjesën e kuotës) që synohet të transferohet, në përputhje me sa parashikohet në pikat 11.4 e vijuese më poshtë.
- Për shmangien e çdo dyshimi, transferimi i kuotave tek një palë e tretë çfarëdo në shkelje të të drejtave parablerjes së ortakëve të tjerë është i parregullt dhe, për këtë arsye, është i pavlefshëm.
- 11.4 Ortaku që synon të shesë ose transferojë pjesën e tij në kapitalin e shoqërisë ose ndonjë pjesë të tij, duhet të njoftojë përmes një shkrese zyrtare ose përmes postës elektronike (“**Njoftimi i Transferimit**”) ortakët e tjerë. Njoftimi duhet të përfshijë të dhënat personale të transferuesit dhe identifikimin e përfituesit, vlerën e kuotës (ose një pjese të saj) që synohet të transferohet,



- kushtet dhe afatet e transferimit, përfshirë çmimin (“**Çmimi i Përshkruar**”) dhe mënyrën e pagesës.
- 11.5 Njoftimi i Transferimit do të specifikojë një periudhë (“**Periudha e Përshkruar**”), e cila nuk do të jetë më pak se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data pasardhëse e lëshimit të Njoftimit për Transferim, periudhë brenda së cilës oferta duhet të pranohet ose refuzohet. Njoftimi për Transferimin, pas dërgimit të tij, është i pakthyeshëm.
- 11.6 Çmimi i Përshkruar do të jetë një çmim që do të përcaktohet nga transferuesi dhe do të konsiderohet se pasqyron një vlerë të drejtë të kuotës.
- 11.7 Ortaku i njoftuar duhet të ushtrojë të drejtën e tij të parablerjes mbi pjesëmarrjen e ortakut/transferuesit të treguar në njoftim, duke i dërguar ortakut që ofron dhe administratorit deklaratën për ushtrimin e së drejtës së tij të parablerjes me një shkresë zyrtare brenda afatit të parashikuar në njoftim.
- 11.8 Nëse, deri në fund të Periudhës së Përshkruar, nuk është marrë asnjë njoftim pranimit ose jo e gjithë pjesa (ose një pjesë e saj) në Njoftimin e Transferimit nuk është pranuar nga blerësi, transferuesi do të ketë të drejtë të transferojë pjesën e tij të një palë të tretë në një çmim i cili nuk është më i ulët se Çmimi i Përshkruar. Transferuesi do të njoftojë paraprakisht me shkrim identitetin e palës së tretë (“**Transferuesi i Synuar**”) të cilit ai synon t’ia shesë kuotën (ose një pjesë të saj) ortakëve të tjerë të shoqërisë.
- 11.9 Pëlqimi me shkrim i ortakëve të tjerë, për transferimin e kuotave tek Transferuesi i Synuar, do të konsiderohet një kusht paraprak për të drejtën e ortakut për të transferuar pjesën e tij (ose një pjesë të saj) të Transferuesit i Synuar.
- 11.10 Asnjë ortak nuk lejohet të vendosë si garanci, të lërë peng apo si ngarkojë me barrë tjetër kuotën përkatëse. Asnjë ortak nuk do të japë opsion apo të drejta të tjera për të disponuar ndonjë interes mbi kuotat e zotëruara prej tyre (përveç transferimit në përputhje me dispozitat e këtij neni 11). Asnjë ortak nuk do të hyjë në ndonjë marrëveshje në lidhje me të drejtat e votës që lind nga posedimi i kuotës përkatëse ose tituj në Shoqëri ose të japë ndonjë opsion në lidhje me to.
- Dispozitat e kësaj pike 11.10 mund të shfuqizohen vetëm në bazë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.11 Çdo transferim i kryer në kundërshtim me dispozitat e mësipërme të këtij neni 11 do të konsiderohet i pavlefshëm dhe ortakut transferues do të jetë përgjegjës ndaj ortakëve të tjerë dhe Shoqërisë për dëmet e shkaktuara.
- 11.12 Dispozitat e këtij neni 11 zbatohen gjithashtu për pasardhësit ligjorë dhe/ose testamentarë të ortakëve (sipas rastit).

### **KAPITULLI III**

#### **ORGANET E SHOQËRISË**

##### **Neni 12**

##### **Asambleja e Përgjithshme**



Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dispozitat e këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, kur merren në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe këtë Statut, janë të detyrueshme për Shoqërinë.

### Neni 13

#### *Të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme*

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për të vendosur në lidhje me çështjet si vijon:
- a. përcaktimin e politikave financiare të Shoqërisë;
  - b. ndryshimin e Statutit;
  - c. emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
  - d. emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe audituesve ligjorë;
  - e. ndarjen e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - f. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
  - g. miratimin e pasqyrave financiare, të raporteve të administrimit dhe mbikëqyrjes, përfshirë, por pa u kufizuar, raportet vjetore të ecurisë së Shoqërisë;
  - h. miratimin e rregullave procedurale në lidhje me mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme;
  - i. miratimin e shpërndarjes së fitimeve vjetore;
  - j. miratimin e skemës së shpërblimit për administratorin, likuiduesit dhe audituesit ligjorë;
  - k. ristrukturimin, prishjen, transformimin, bashkimin, ose likuidimin e Shoqërisë ose riorganizimin e saj në një formë tjetër ligjore;
  - l. ndryshimin i statusit ligjor dhe/ose formës ligjore dhe mbylljen e Shoqërisë;
  - m. blerjen e kuotave/aksioneve në shoqëri të tjera ose transferimin e kuotave/aksioneve të Shoqërisë ose të ndonjë pjesëmarrjeje që Shoqëria ka në shoqëri të tjera;
  - n. themelimin, mbylljen dhe/ose likuidimin e degëve, zyrave të përfaqësimit dhe shoqërive të kontrolluara;
  - o. lidhjen e çdo marrëveshjeje e cila, gjatë afatit të saj, parashikon kryerjen e pagesave që tejkalojnë vlerën prej 1,500,000 USD (nje milion e peseqind mije ) USD;
  - p. çdo lloj shitje, blerje apo transferim të pronave/aseteve të paluajtshme të Shoqërisë tek palë të treta;
  - q. marrjen e borxheve, ose garantimin e borxheve, që tejkalon vlerën prej 1,500,000 USD (nje milion e peseqind mije ) USD; për çdo borxh;
  - r. mosshpërndarjen e fitimit sipas nenit 21 të këtij Statuti (*Shpërndarja e fitimit*);
  - s. angazhimin e Shoqërisë në çdo biznes tjetër përveç veprimtarisë tregtare të saj;
  - t. përveç sa parashikohet dhe identifikohet në mënyrë specifike nga buxheti (nese ka një të tillë), realizimin e shpenzimeve kapitale që tejkalojnë vlerën prej 1,500,000 USD (nje milion e peseqind mije ) USD; në çdo vit fiskal. Kjo, pa cënuar sa parashikuar në gërmat "o" dhe "q" të kësaj pike 13.1 të këtij neni 13;



- u. fillimin ose zgjidhjen e çdo procesi gjyqësor material jashtë rrjedhës së zakonshme të veprimtarisë tregtare;
  - v. çdo çështje tjetër e përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe/ose këtë Statut.
- 13.2 Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b. shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c. investime;
  - d. vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

#### Neni 14

##### *Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme*

- 14.1 Asambleja e Përgjithshme thirret në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi dhe ky Statut, sa herë që mbledhja e saj është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e Ortakeve thirret në përputhje me nenet 83 dhe 84 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe këtë Statut.
- 14.2 Administratori në diskrecionin e tij, ose me kërkesë të një dhe/ose më shumë ortakeve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të të gjithë kapitalit të Shoqërisë dhe/ose audituesit ligjorë (nëse ka të tillë), si dhe/ose likuiduesit, kanë të drejtë të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme. Një njoftim me shkrim i mbledhjes, duke përmendur qëllimin (et), vendin, datën dhe kohën e mbledhjes, do t'i dorëzohet nëpërmjet postës së regjistruar/e-mailit secilit ortak jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para datës së mbledhjes.
- 14.3 Njoftimi i mbledhjes dërgohet me postë të regjistruar dhe/ose e-mail.
- 14.4 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mbahen në ambientet e Shoqërisë ose në ndonjë vend tjetër jashtë tyre, pavarësisht nëse këto vende ndodhen në Shqipëri, ose diku tjetër jashtë Shqipërisë.
- Për ortaket që banojnë në Shqipëri, kostot dhe shpenzimet për pjesëmarrjen në një mbledhje që do të zhvillohet jashtë vendit do të përballohen nga vetë ortaket.
- 14.5 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të bëhen gjithashtu përmes video-konferencave dhe/ose formave të tjera, mjeteve, kanaleve dhe/ose platformave të komunikimit elektronik, dixhital dhe/ose në internet, për sa kohë që identifikimi i secilit ortak është i mundshëm teknikisht dhe pasqyrohet siç duhet në procesverbalin e mbledhjes.
- Në një rast të tillë, detajet specifike se si do të zhvillohet mbledhja do t'u njoftohen ortakeve përmes një njoftimi zyrtar për mbledhjen.





- 14.6 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme do të zhvillohen në gjuhën Angleze. Çdo ortak ose përfaqësues i ortakut do të sigurojë shërbimet e përkthimit për veten e tij, nëse nuk ka aftësitë e nevojshme në gjuhën angleze.

#### **Neni 15**

##### ***Pjesëmarrja në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme***

- 15.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, duke pasur të drejtë për një numër votash të barabartë me përqindjen e kuotës që zotëron në kapitalin e Shoqërisë.
- 15.2 Secili ortak ka të drejtë të përfaqësohet në procesin e vendimmarrjes nga një ortak tjetër, nga bashkëshorti ose nga ndonjë person tjetër fizik, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, me kusht që përfaqësuesit të autorizohen me prokurë për një qëllim të tillë.
- 15.3 Administratori i Shoqërisë mund të marrë pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, por nuk mund të përfaqësojë asnjë nga ortakët në ndonjë prej mbledhjeve.

#### **Neni 16**

##### ***Kuorumi dhe vendimmarrja***

- 16.1 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme në çdo rast është e vlefshme nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e kapitalit të Shoqërisë marrin pjesë në mbledhjen përkatëse.
- 16.2 Për vendimet që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me shumicën e votave të ortakeve të pranishëm në mbledhje në përputhje me pikën 16.1 më lart.
- 16.3 Për vendimet që kërkojnë një shumicë të cilësuar, Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme me 3/4 (*tre të katërtat*) e votave të ortakeve të pranishëm në mbledhje, sipas korumit të treguar në pikën 16.1 më lart. Vendime të tilla përfshijnë edhe gjerat "b", "e", "f", "i", "k", "l", "m" dhe "n" të pikës 13.1 të nenit 13 të Statutit.
- 16.4 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të thirret për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 16.1 më lart, Asambleja e Përgjithshme do të thirret përsëri jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.
- 16.5 Asambleja e Përgjithshme gjithashtu mund të marrë vendime të vlefshme përmes një vendimi qarkullues.

#### **Neni 17**

##### ***Procesverbali i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme***

- 17.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme regjistrohen në procesverbalin e mbledhjes. Procesverbali i mbledhjes duhet të përmbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit të mbledhjes, emrin e sekretarit dhe rezultatet e votimit, si dhe çdo informacion tjetër të detyrueshëm të përcaktuar në dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.



- 17.2 Kryetari i mbledhjes cakton një sekretar/e me qëllimin mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes, i cili mund të mos jetë ortak. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari i mbledhjes dhe sekretari.
- 17.3 Lista e pjesëmarrësve dhe njoftimi për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve i bashkëlidhen procesverbaleve të mbledhjeve.
- 17.4 Në rast të vendimeve të marra me anë të një vendimi qarkullues, vendimi duhet të nënshkruhet nga secili ortak në mënyrë që të jetë i vlefshëm.

## Neni 18


### *Administrimi i Shoqërisë*

- 18.1 Shoqëria do të administrohet nga 1 (një) ose më shumë administratorë, të emëruar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.2 Administratori i Shoqërisë emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare (e rinovueshme). Administratori mund të shkarkohet përpara skadimit të mandatit, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.3 Administratori është përgjegjës për administrimin e Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe/ose dispozitat e legjislationit në fuqi. Administratori ka të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, përveç atyre kompetencave që janë të rezervuara për organet e tjera të Shoqërisë sipas këtij Statuti dhe/ose legjislationit në fuqi.
- 18.4 Administratori ka kompetencat dhe detyrat e mëposhtme në lidhje me administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë:
- a. të mbikëqyrë dhe zbatojë politikat tregtare të Shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme;
  - b. me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakeve, të marrë masa në kompetencë të tij, të rekomandojë vendime për tu marrë nga Asambleja e Përgjithshme dhe të zbatojë këto vendime;
  - c. të sigurojë që Shoqëria respekton legjislationin në fuqi dhe standardet e kontabilitetit;
  - d. të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e veprimtarisë tregtare të Shoqërisë;
  - e. të përfaqësojë Shoqërinë përballë palëve të treta;
  - f. të sigurojë që dokumentet dhe librat e kontabël të Shoqërisë të mbahen si duhet dhe të rregullta;
  - g. të thërrasë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kur çmohet e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë;
  - h. të përgatisë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore të Shoqërisë, pasqyrat financiare të konsoliduara, të cilat i paraqiten Asamblesë së Përgjithshme për miratim, së bashku me propozimin për shpërndarjen e fitimeve, si dhe raportet vjetore të ecurisë së Shoqërisë;





- i. të kryejë të gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme në lidhje me Shoqërinë, siç mund të kërkohet nga legjislacioni në fuqi;
  - j. t'i raportojë Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare;
  - k. të miratojë fillimin apo përfundimin e ndonjë procedure ligjore;
  - l. të kryejë cdo veprim, detyrë, kompetencë dhe/ose akt tjetër siç përcaktohet nga legjislacioni në fuqi dhe/ose ky Statut.
- 18.5 Administratori mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e Shoqërisë dhe të kryejë të gjitha veprimet e ligjshme, detyrat, kompetencat dhe/ose veprimet që – na bazë të ligjit, Statutit, apo cdo forme tjetër – nuk kërkohet të ushtrohen/kryhen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 18.6 Administratori i Shoqërisë është zj. **Esmeralda Konda**, shtetase shqiptar, lindur më 05.06.1985, në Fier, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. personal: I55605102T.

Të dhëna për administratorin	Specimeni i nënshkrimit
<b>Esmeralda Konda</b> Shtetase shqiptare Lindur më 05.06.1985 Numër personal identifikimi: I55605102T	

#### KAPITULLI IV

#### **AUDITIMI LIGJOR, VITI FINANCIAR DHE PASQYRAT FINANCIARE, SHPERNDARJA E FITIMIT**

##### **Neni 19**

##### *Auditimi ligjor*

Nëse është e nevojshme, ose kërkohet nga ligji, rishikimi i pasqyrave financiare dhe regjistrave kontabël të Shoqërisë do të kryhet nga një auditues i ligjëruar, i caktuar nga Asambleja e Përgjithshme.

##### **Neni 20**

##### *Viti financiar dhe pasqyrat financiare*

- 20.1 Viti financiar fillon më datë 1 Janar dhe mbaron më datë 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbaron më 31 Dhjetor të vitit 2020.
- 20.2 Shoqëria duhet të mbajë në mënyrë të plotë dhe të saktë librat kontabël të saj në adresën e saj të veprimtarisë, si dhe në vende të tjera të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme. Këto dokumente, ndër të tjera, duhet të përbajnë të gjitha të ardhurat, shpenzimet, asetet dhe detyrimet e Shoqërisë.



- 20.3 Pasqyrat financiare vjetore dhe, nëse është rasti, raporti i audituesit ligjor miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.

#### **Neni 21**

##### ***Shpërndarja e fitimit***

Ortakët kanë të drejtë të marrin fitimin e deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë. Llogaritja e fitimit kryhet në fund të çdo viti financiar. Fitimi shpërndahet midis ortakëve proporcionalisht me përqindjen e pjesëmarrjes së secilit prej tyre në kapitalin e Shoqërisë. Në mungesë të një vendimi të kundërt sipas germës "r" të nenit 13, Shoqëria shpërndan fitimin çdo vit, në përputhje me nenin 77 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

### **KAPITULLI V**

#### ***RIORGANIZIMI I SHOQËRISË, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË***

#### **Neni 22**

##### ***Prishja/likuidimi dhe riorganizimi i Shoqërisë***

- 22.1 Shoqëria mund të prishet sipas rasteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Prishja e Shoqërisë do të pasohet nga procedura e likuidimit.
- 22.2 Procedura e likuidimit kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 22.3 Në rast prishjeje vullnetare të Shoqërisë, likuiduesi/ët emërohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Procedura e likuidimit dhe emërimit të likuiduesve kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 22.4 Shoqëria mund të ndryshojë formën e saj ligjore sipas legjislacionit në fuqi. Riorganizimi nuk do të ketë pasoja në të drejtat dhe detyrimet që Shoqëria ka marrë persiper kundrejtë palëve të treta.

### **KAPITULLI VI**

#### ***DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE***

#### **Neni 23**

##### ***Zgjidhja e mosmarrëveshjeve dhe ligji i zbatueshëm***

- 23.1 Shoqëria është themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe ky Statut është hartuar dhe miratuar në përputhje me këto ligje.
- Dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare do të zbatohen në lidhje me të gjitha çështjet që nuk janë të rregulluara në këtë Statut. Në rast të mospërputhjeve midis dispozitave të këtij Statuti dhe atyre të legjislacionit shqiptar në fuqi, dispozitat e këtij të fundit do të mbizotërojnë.
- 23.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin ose interpretimin e këtij Statuti, çdo mosmarrëveshje që lind midis Shoqërisë dhe palëve të treta do të paraqitet për zgjidhje përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



**Neni 24**

***Të ndryshme***

Ky Statut është hartuar në 2 (dy) kopje, me të njëjtën vlerë ligjore dhe përmbajtje, në gjuhët Shqipe dhe Angleze.

Në rast mospërputhjeje midis versionit anglisht dhe shqip, versioni anglisht do të prevalojë.

Nënshkruar sot, më 05.11.2020:

**Për ORTAKUN E VETËM**

**(Dexi Global Inc.)**

JACOB LAURVIGEN

Jacob Laurvigen

Drejtore Ekzekutive

dhe përfaqësues ligjor



**BYLAWS**  
**OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY**  
**"Dexi AL" SHPK**

Today, on 5.11.2020, is established a limited liability company, in accordance with the provisions of the law no. 9901, dated 14.04.2008 "*On entrepreneurs and commercial companies*" as amended (hereinafter, "**Law on Commercial Companies**"), by the following legal entity:

*"Dexi Global Inc., a company existing and organized under the laws of State of Delaware, United States of America, and registered office at the address: "Cogency Global Inc., 850 New Burton Road, Suite 201, Dover, Kent County, Delaware 19904", represented by the Chief Executive Officer and authorized representative, Mr. Jacob Laurvigen".*

The company and the relations between their shareholders are governed by the Albanian legislation in force and articles of these bylaws (hereinafter, the "**Bylaws**"), which are deemed also as articles of incorporation thereof.

**CHAPTER I**

**ESTABLISHMENT, DENOMINATION, REGISTERED SEAT, SCOPE OF ACTIVITY,  
DURATION, BRANCH AND REPRESENTATIVE OFFICES, RESPONSIBILITY OF  
SHAREHOLDERS**

**Article 1**

***Establishment and Denomination***

- 1.1 On 05.11.2020, the abovementioned shareholder established a limited liability company denominated "**Dexi AL**" (hereinafter, the "**Company**"). The Company acquires legal personality after its registration with the Albanian Commercial Register, held by the National Business Center.
- 1.2 The change of the denomination of the Company shall be decided upon a resolution of the General Assembly.

**Article 2**

***Legal form***

- 2.1 "**Dexi AL**" is a limited liability company (SHPK).
- 2.2 During its existence, to the Company's name will be associated the suffix "SHPK" indicating its legal form of a limited liability company as per the Albanian legislation in force.

**Article 3**

***Registered Seat***

- 3.1 The registered seat of the Company shall be at the address: "*Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Kulla nr. 2, kati i dyte, Tirana, Albania*".

- 3.2 The Company may change its registered seat upon a resolution of the General Assembly.

#### **Article 4**

##### ***Scope of activity***

- 4.1 The Company's scope of activity in Albania is the performance of professional services and processing of internet data.
- 4.2 The Company may carry out all commercial, industrial, financial operations, operations with movable and immovable property deemed necessary or useful to exercise and fulfil its scope of activity, specifying that the financial activity may be carried out solely for and in the ambit of such scope of activity.
- 4.3 Generally, the Company may perform any necessary and useful activity, permitted by legislation in force for and in the ambit of fulfilling and exercising its scope of activity.
- 4.4 The Company may offer other services and perform other activities upon a resolution of the General Assembly, pursuant to the legislation in force.
- 4.5 The Company may amend the scope of its activity, at any time, in accordance with the provisions of the Law on Commercial Companies and these Bylaws.

#### **Article 5**

##### ***Duration***

- 5.1 The Company shall perform its activity for an unlimited period of time, starting from the date of the registration on the commercial register.
- 5.2 By decision of the General Assembly and in accordance with the rules defined herein, the Company may change the duration of the Company's activity.

#### **Article 6**

##### ***Branches and Representative Offices***

The Company may open branches, subsidiaries, representative offices and transact business at other locations, either within or out of the territory of the Republic of Albania, upon a resolution of the General Assembly.

#### **Article 7**

##### ***Shareholders' Responsibility***

- 7.1 The shareholders are not responsible for the liabilities of the Company and personally cover the losses of the Company up to their unpaid contributions in the share capital.
- 7.2 The shareholders shall exercise their duties with due care and loyalty in compliance with the provisions of the legislation in force.



## CHAPTER II

### ***SHARE CAPITAL AND SHARES, INCREASE AND DECREASE OF SHARE CAPITAL, TRANSFER OF THE SHARES***

#### **Article 8**

##### ***Registered capital and shares***

- 8.1 The share capital of the Company is in money, equal to ALL 100 (one hundred Albanian Leke). The share capital is unpaid.
- 8.2 The share capital is composed of 1 (one) share, with a nominal value of ALL 100 (one hundred Albanian Leke), corresponding to 100% (one hundred percent) of the share capital of the Company, which is fully owned and entirely subscribed by the following shareholder:
- **Dexi Global Inc.**, a company existing and organized the laws of State of Delaware, United States of America, with registered office at the address: "*Cogency Global Inc., 850 New Burton Road, Suite 201, Dover, Kent County, Delaware 19904*".

#### **Article 9**

##### ***Increase of share capital***

The share capital may be increased at any time, upon a resolution of the General Assembly.

#### **Article 10**

##### ***Decrease of the registered capital***

The Company may decrease the registered capital, upon a resolution of the General Assembly.

#### **Article 11**

##### ***Transfer of the shares of the registered capital***

- 11.1 The transfer of the shares shall be executed only through a written document as per the Albanian legislation in force.
- 11.2 In case of more than 1 (one) shareholder participating in the share capital of the Company, the following restrictions (set out under points 11.3 *et. seqq.* of this article 11) will be applied on the share transfer aiming at protecting the interests of the Company, the unity of the shareholders and the stability of their relationship.
- 11.3 In case a shareholder wishes to transfer their share (including a transfer without compensation) to third parties, the transfer is subject to the pre-emptive right of the existing shareholders of the Company over the share (part of the share) intended to be transferred, in accordance with as provided for under point 11.4 *et. seqq.* below.
- For avoidance of any doubt, the transfer of shares to a third party whosoever in breach of the pre-emptive right of the other shareholders is invalid and, therefore, null and void.
- 11.4 The shareholder intending to sell or transfer their participation in the share capital or any part thereof, should notify through registered letter or through e-mail (the "***Transfer Notice***") the





other shareholders. The notice should include the personal data of the transferor and identification of the beneficiary, the value of the share (or part thereof) intended to be transferred, the terms and conditions of the transfer, including the price (the "*Prescribed Price*") and modality of payment.

- 11.5 The Transfer Notice shall specify a period (the "*Prescribed Period*"), which shall not be less than 60 (sixty) days from the next date of the Transfer Notice issued, period within which the offer must be accepted or refused. The Transfer Notice once issued must be irrevocable.
- 11.6 The Prescribed Price shall be a price to be determined by the transferor and will be deemed to reflect a fair value of the share.
- 11.7 The notified shareholder should exercise their pre-emptive right on the participation of the shareholder/transferor indicated in the notification, by sending to the offering shareholder and to the administrator the declaration for exercising their pre-emptive right with a registered letter within the term provided for in the notification.
- 11.8 If by the end of the Prescribed Period, no acceptance notice has been received or not all the shares (or part thereof) in the Transfer Notice are accepted by the buyer, the transferor will be entitled to transfer their share to a third party at a price which is not lower than the Prescribed Price. The transferor shall give prior notice in writing of the identity of the third party (the "*Intended Transferee*") whom he intends to sell the share (or part thereof) to the other shareholders of the Company.
- 11.9 The written consent of the other shareholder(s) for the transfer of the shares to the Intended Transferee, shall be considered a preliminary condition on the right of the shareholder to transfer their share (or part thereof) to the Intended Transferee.
- 11.10 No shareholder is allowed to apply any warrant, pledge, lien or any other encumbrance of any other burden in the shares. No shareholder shall grant any option or other rights to dispose of any interest in shares held by them (except the transfer in accordance with the provision of this article 11). No shareholder shall enter into any agreement with respect to the voting rights attached to all or any of their shares or other securities in the Company or grant any option in relation thereto.
- The provisions of this point 11.10 might be abrogated only in virtue of a decision of the General Assembly.
- 11.11 Any transfer performed in breach of the above provisions of this Article 11 will be considered invalid and the transferring shareholder shall be liable towards the other shareholders and the Company for the damages caused.
- 11.12 The provisions of this Article 11 apply also to the legal and/or testamentary successors of the Shareholders (as the case might be).

### **CHAPTER III**

#### **GOVERNING BODIES OF THE COMPANY**

##### **Article 12**

##### **General Assembly**



Pursuant to the applicable legislation and provisions of these Bylaws, the General Assembly is the highest decision-making body of the Company. The resolutions of the General Assembly, when taken in accordance with the legislation in force and the present Bylaws, are legally binding for the Company.

### Article 13

#### *Rights and obligations of the General Assembly*

- 13.1 The General Assembly is responsible for resolving on the following matters:
- a. determination of the business policies, budget and business plan of the Company;
  - b. amending of the Bylaws;
  - c. appointment and dismissal of the administrator;
  - d. appointment and dismissal of liquidators and authorized auditors;
  - e. division of shares and their annulment;
  - f. increase or decrease of the share capital;
  - g. adoption and approval of the annual statement of accounts, of the administration and supervision reports, including, without limitation, the annual reports on the progress of activity of the Company;
  - h. approval of procedural rules with regard to meetings of the General Assembly and Company regulations;
  - i. approval of the distribution of annual profits;
  - j. approval of the compensation scheme for Administrator, liquidators and authorized auditors;
  - k. restructuring, dissolution, transformation, merger, amalgamation, winding up or liquidation of the Company or the reorganization of the Company into another corporate form;
  - l. change of the legal status and/or legal form and termination of the Company;
  - m. acquisition of shares in other companies or transfer of shares of the Company or of any participation that the Company has in other companies;
  - n. establishment, closing and/or winding up of any branch offices, affiliates and subsidiaries;
  - o. entering into any agreement which provides for payments over the entire term of the relevant agreement in excess of 1,500,000 USD (one million and five hundred thousand USD);
  - p. any type of sale, purchase, or transfer of the immovable properties of the Company to a third party;
  - q. incurring any indebtedness, or guaranteeing any indebtedness, which exceeds 1,500,000 USD (one million and five hundred thousand USD) per each indebtedness;
  - r. a decision not to distribute dividends as per Article 21 herein (*Profit Distribution*);



- s. engagement of the Company in any business other than the business activity of the Company;
  - t. except as specifically contemplated and identified by the budget (if any), incurring capital expenditures in excess of 1,500,000 USD (one million and five hundred thousand USD) in any fiscal year. This is without prejudice to letters "o" and "q" of this point 13.1 of article 13;
  - u. commencement or settlement of any material litigation outside the ordinary course of business;
  - v. any other matters set forth by the legislation in force and/or these Bylaws.
- 13.2 If the Company is owned by a sole shareholder, the rights and obligations of the General Assembly are exercised by the sole shareholder. All resolutions taken by the sole shareholder are filed with the registry of resolutions of the Company, which data cannot be changed or erased. Especially, but without limitation, the following resolutions should be registered with the said registry:
- a. the approval of the annual financial statements and of the annual reports on the progress of activity of the Company;
  - b. resolutions on distribution of dividends and covering of Company's losses;
  - c. resolutions on performance of investments;
  - d. resolutions on reorganization and dissolution of the Company.

The resolutions that are not registered with the registry of resolutions of the Company are null and void.

#### **Article 14**

##### ***Convocation of the General Assembly***

- 14.1 The General Assembly shall be convened in the cases provided for by the legislation in force and these Bylaws, as many times as the meeting is necessary to protect the interests of the Company. The General Assembly is convened at least once a year. The General Assembly is convened pursuant to the articles 83 and 84 of Law on Commercial Companies and these Bylaws.
- 14.2 The Administrator at his/her own discretion or upon request of one and/or more shareholders representing at least 5% (five percent) of the entire share capital of the Company, and/or the authorized auditor if any, and/or by the liquidators are entitled to convoke the General Assembly. A written notice of the meeting, stating the purpose(s), place, date and time of the meeting, shall be delivered by registered mail and/or e-mail to each Shareholder not later than 7 (seven) days before the date of the meeting.
- 14.3 The notification of the meeting is sent by registered mail and/or e-mail.
- 14.4 The meetings of the General Assembly are held at the premises of the Company or at any other places outside them, irrespective of these places being situated in Albania, or elsewhere abroad. For the shareholders residing in Albania, the costs and expenses for the participation in a meeting that will take place outside the country are borne by such shareholders themselves.



- 14.5 The meetings of the General Assembly might take place also through video-conferences and/or other forms, means, channels and/or platforms of electronic, digital and/or online communication, as long as the identification of each shareholder is technically enabled and duly reflected in the minutes of the meeting. In such case, the specific details on how the meeting shall take place will be notified to the shareholders through the official notification for meeting.
- 14.6 The meetings of the General Assembly will take place in the English language. Any shareholder or Shareholder's representative shall arrange themselves for translation services, if lacking the necessary competences in English language.

#### **Article 15**

##### ***Participation at the meeting of the General Assembly***

- 15.1 Each shareholder is entitled to participate in the meetings and decisions of the General Assembly, being entitled to a number of votes equal to the percentage of the share owned in the share capital.
- 15.2 Each shareholder is entitled to be represented in the decision-making process by another shareholder, by the consort or by any other person in accordance with the provisions of the legislation in force, provided that the representatives are authorized upon power of attorney for such purpose.
- 15.3 The administrator of the Company may participate in the meeting of the General Assembly, but may not represent any of the shareholders in any of such meetings.

#### **Article 16**

##### ***Quorum and decision making***

- 16.1 The convening of the General Assembly in any case is valid if the shareholders who own more than half of the share capital of the Company attend the relevant meeting.
- 16.2 For decisions that require an ordinary majority, the General Assembly makes valid decisions with the majority of votes of the Shareholders present in the meeting in accordance with point 16.1 above.
- 16.3 For decisions requiring a qualified majority, the General Assembly makes valid decisions with 3/4 (three fourth) of the votes of the shareholders present in the meeting in as per quorum indicated under point 16.1 above. Such decisions include the letters "b", "e", "f", "i", "k", "l", "m" and "n" of point 13.1 of article 13 of the Bylaws.
- 16.4 If the General Assembly may not be convened due to the absence of the quorum referred to in point 16.1 above, the General Assembly shall be convened again no later than 30 (thirty) days, with the same agenda.
- 16.5 The General Assembly might also take valid decisions through circulation act.

#### **Article 17**

##### ***Minutes of meeting of the General Assembly***

- 17.1 All decisions of the General Assembly must be recorded in the minutes of the meeting. The minutes of the meeting must contain the date, the place of the meeting, the agenda, the name of the chairman of the meeting, the name of the secretary and the voting results, as well as any other obligatory information set out by the Law on Commercial Companies.
- 17.2 The chairman of the meeting appoints a secretary thereof to keep the minutes of the meeting. The minutes of the meeting are signed by the chairman of the meeting and the secretary.
- 17.3 The list of participants and the notification for the meeting of the General Assembly are attached to the minutes of the meetings.
- 17.4 In case of resolutions taken through circulation act, the resolution should be signed by each shareholder in order to be valid.

## **Article 18**


### ***Management of the Company***

- 18.1 The Company will be managed by 1 (one) or more administrators, appointed through decision of the General Assembly.
- 18.2 The administrator of the Company is appointed for a period of 5 (five) years (renewable). The administrator may be dismissed before the expiration of the term upon decision of the General Assembly.
- 18.3 The administrator shall be responsible for the Company's management and shall represent the Company towards third parties subject to and in accordance with the provisions of these Bylaws and/or the provisions of the legislation in force. The administrator shall have all powers of ordinary and extraordinary management of the Company, except for those powers that are reserved for other bodies of the Company as per these Bylaws and/or legislation in force.
- 18.4 The administrator shall have the following powers and duties with regard to the management of the Company's activity:
  - a. to supervise and implement the business policies of the Company and decisions of the General Assembly;
  - b. upon request of the General Assembly, to adopt measures which fall within the competencies of the latter, to recommend the resolutions to be adopted by the General Assembly and to execute such resolutions;
  - c. to ensure that the Company observes the legislation in force and accounting standards;
  - d. to perform all actions in relation to the administration of the commercial activity of the Company;
  - e. to represent the Company toward third parties;
  - f. to manage that the documents and the accounting books of the Company are properly and regularly held;
  - g. to convoke a meeting of the General Assembly when deemed necessary for the safeguard of the Company's interests;





- h. to prepare and sign the annual financial statements of the Company, the consolidated financial statements, which are to be submitted to the General Assembly for approval together with the proposal on the distribution of profits, as well as annual report on progress of activity of the Company;
  - i. to perform all mandatory registrations and publications with regard to the Company, as may be required by the legislation in force;
  - j. to report to the General Assembly with regard to the implementation of commercial policies;
  - k. to approve the commencement of any legal proceeding or the termination of the same;
  - l. to carry out any other actions, tasks, competences and/or acts as set out by the legislation in force and/or these Bylaws.
- 18.5 The administrator may exercise all such powers of the Company and carry out all such lawful actions, tasks, competences and/or acts that as are not – by letter of law, limited by means of these Bylaws or otherwise – required to be exercised/carried out by the General Assembly.
- 18.6 The administrator of the Company is Mr. **Esmeralda Konda**, Albanian citizen, born on 05.06.1985, in Fier, Albania, holder of the ID card with personal no.: I55605102T.

Data related to the Administrator	Signature specimen
<b>Esmeralda Konda</b> Albanian Citizen Born on 05.06.1985 ID no: I55605102T	

#### CHAPTER IV

#### **STATUTORY AUDITOR, FINANCIAL YEAR AND FINANCIAL STATEMENTS, PROFIT DISTRIBUTION**

##### **Article 19**

##### ***Statutory auditor***

If it is necessary or required by law, the revision of the financial statements and accounting records of the Company shall be carried out by a statutory auditor, appointed by the General Assembly.

##### **Article 20**

##### ***Financial year and financial statements***

20.1 The financial year begins on 1<sup>st</sup> day of January and ends on the 31<sup>st</sup> day of December of each year. Exceptionally, the first financial year begins in the date of registration of the Company with Albanian Commercial Register and expires on 31<sup>st</sup> of December of 2020.





- 20.2 The Company shall maintain complete and accurate books of account of the Company's affairs at the Company's principal place of business and at such other place or places as determined by the General Assembly. Such books shall include, *inter alia*, all income, expenditures, assets and liabilities of the Company.
- 20.3 The annual financial statements and, as the case might be, the statutory audit report, are approved by the General Assembly.

#### **Article 21**

##### ***Profit distribution***

The shareholders are entitled to obtain the profit declared in the financial statements of the Company. The calculation of the profit is performed at the end of each financial year. The profit is distributed among the shareholders proportionately with the percentage of participation of each of them in the share capital of the Company. Absent a decision to the contrary pursuant to letter "r" of point 13.1 of article 13, the Company shall distribute the profit each year, subject to compliance with article 77 of the Law on Commercial Companies.

#### **CHAPTER V**

##### ***REORGANIZATION OF THE COMPANY, DISSOLUTION AND LIQUIDATION OF COMPANY***

#### **Article 22**

##### ***Dissolution/Liquidation and Reorganization of the Company***

- 22.1 The Company may be dissolved pursuant to the cases provided by the legislation in force or by resolution of the General Assembly. The dissolution of the Company will be followed by the liquidation procedure.
- 22.2 The liquidation procedure shall be made pursuant to the Albanian legislation in force.
- 22.3 In case of voluntary dissolution of the Company, the liquidator/s shall be appointed upon resolution of the General Assembly. The procedure of liquidation and appointment of liquidators shall be carried out in accordance with the Albanian legislation in force.
- 22.4 The Company may change its legal form according to the legislation in force. The reorganization does not have consequences on the rights and obligations that the Company has undertaken to third parties.

#### **CHAPTER VI**

##### ***FINAL PROVISIONS***

#### **Article 23**

##### ***Dispute resolution and Governing Law***

- 23.1 The Company is established as per the laws of the Republic of Albania and these Bylaws are drawn up and approved in accordance with such laws.



The provisions of the Law on Commercial Companies shall apply regarding all aspects that are not regulated by the present Bylaws. In case of discrepancies between the provisions of these Bylaws and those of the Albanian legislation in force, the latter's provisions will prevail.

- 23.2 All disputes that may arise concerning application or interpretation of these Bylaws, any disputes arising between the Company and third parties as well shall be brought for resolution before the District Court of Tirana.

#### **Article 24**

##### ***Miscellaneous***

The present Bylaws are drafted in 2 (*two*) copies, with the same legal value and content, in the Albanian and English languages.

In case of discrepancies between the English and Albanian version, the English version shall prevail.

Signed today, on 05.11.2020:

**For the SOLE SHAREHOLDER**

**(Dexi Global Inc.)**

JACOB LAURVIGEN

Jacob Laurvigen

Chief Executive Officer

and authorized representative